

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc.Rafet Haxhaj, kryetar dhe Lumni Sallauka e Hunaida Pasuli anëtarë, në çështjen kontestimore të paditësit – propozuesit të sigurimit Mejdi Bektashi nga Prishtina, të cilin e përfaqësojnë Hamdi Podvorica dhe Arsim Billalli, që të dy avokat nga Prishtina, kundër të paditurës – kundërshtares së sigurimit OJQ “ADMOVERE” me seli në Prishtinë, me themelues Shkëlzen Gashi nga Prishtina, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Rina Kika, avokate nga Prishtina, me objekt kontesti, shpifje dhe fyerje, për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës – kundërshtares së sigurimit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2884/18 të datës 08.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.02.2019, mori këtë:

#### AKTVENDIM

PRISHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2884/18 i datës 08.11.2018, ndërsa çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rivendosje.

#### A r s y e t i m

Me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë në pikën I., të dispozitivit aprovohet propozimi i palës paditëse-propozuesit të sigurimit Mejdi Bektashi nga Prishtina për caktimin e masës së sigurisë, caktohet masa e sigurimit dhe i ndalohet të paditurës –kundërshtares të sigurimit OJQ “ADMOVERE” me seli në Prishtinë, t’i përsëritë në të ardhmen sjelljet e publikimit, deklaratat, njoftimin apo informacionin, në raport me personalitetin e propozuesit të sigurimit, lidhur me studimin “Stafi akademik i UP-së, studimet, angazhimet tjera, plagjiaturat, vlerësimet dhe përpjesa stafi-student”, vetëm në pjesën e studimit, që ka të bëjë me propozuesin. Në pikën II., të dispozitivit e paditura - kundërshtarja e sigurimit OJQ “ADMOVERE” me seli në Prishtinë, me themelues Shkëlzen Gashi nga Prishtina, detyrohet që të tërheqë nga publikimi-qarkullimi i mëtejme, studimin me emërtimin “Stafi akademik i UP-së, studimet, angazhimet tjera, plagjiaturat, vlerësimet dhe përpjesa staf-student” nga mediat e shkruara, elektronike, ueb-faqe te internetit dhe në rrjete sociale, vetëm pjesën e studimit që ndërlidhet me personalitetin e paditësit - propozuesit, deri në përfundimin e këtij kontesti me vendim të formës së prerë, apo deri në një vendim tjetër të kësaj gjykate, nën kërcënim të pasojave ligjore. Në pikën III., të dispozitivit është vendosur që

aktvendimi i shkallës së parë ti dorëzohet palëve ndërgjyqës dhe Komisionit të pavarur të mediave (KPM), me seli në Prishtinë.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur e paditura - kundërshtarja e sigurimit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktvendimin e atakuar ta shfuqizoj.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësi - propozuesi Mejdin Bektashi, me të cilën ka kërkuar që Gjykata e Apelit e Kosovës ta refuzoj ankesën e të paditurës - kundërpropozuesit ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar kurse aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë ta vërtetoj.

### **Gjetjet e Gjykatës së Apelit**

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, dhe pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194, 208 dhe 209 të LPK, gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi ka paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër të paditurës për shpifje. Paditësi së bashku me padi ka paraqitur propozimin me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesa e paditësit dhe të caktohet masa e sigurisë me të cilën i ndalohet të paditurve "ADMOVERE" me përfaqësues Shkëlzen Gashi përsëritja e publikimit të çfarë do deklaratë, prononcimi, njoftimi, informacioni, raporti etj, në lidhje me paditësin Mejdin Bektashi deri në vendosjen me aktgjykim të formës së prerë. Paditësi po ashtu me padi ka kërkuar që të aprovohet kërkesa e paditësit dhe të caktohet masa e sigurisë me të cilën urdhërohet e paditura ADMOVERE, që ti fshijnë të gjitha raportet dhe deklaratat e publikuara, si dhe ta tërheqin nga qarkullimi "Studimin" në fjalë që është shtypur në Print Impress, në tirazh prej 300 kopje, në lidhje me Mejdin Bektashi të cilat janë të publikuara në mediat e shkruara, ueb-faqe, faqe të internetit gjegjësisht rrjete sociale deri në nxjerrjen e aktgjykimit nga gjykata. Përfaqësuesi i të paditurit me parashtrësën e tij ka hequr dorë nga propozimi për caktimin e masës së sigurisë ndaj të paditurit të dytë Luan Shllaku drejtor ekzekutiv, KFOS që është edhe financuesi dhe porositësi i këtij hulumtimi, ndërsa mbetet pranë propozimit të caktimit për masën e sigurisë ndaj të paditurit të parë OJQ Admovere, e përfaqësuar nga Shkëlzen Gashi i cili është botues i këtij hulumtimi.

Në pretendimet e kundërshtares së sigurimit ndër të tjera është theksuar që e paditura ka përdorur si burim kryesor të informacionit artikullin e botuar në "Gazeten Ekspres" të datës 04.02.2007 me titull "Shumë Plagjiaturë". Asnjë demantim/përgënjeshtër nuk është publikuar nga Gazeta "Ekspres" në lidhje me këtë artikull. Më tutje është thënë se *deklarata e cila vihet në dyshim të jetë shpifje është verifikuar nga e paditura*, ndërkaq, gjatë hulumtimit të të paditurës nuk është gjetur vendimi i rektorit të cilin paditësi e ka bashkangjitur në padi për shkak se nuk është i qasshëm në ueb faqen e Universitetit të Prishtinës.

Gjykata e shkallës së parë ka marr vendim duke u bazuar në të dhënat si: Vendimi me nr.1/191 të datës 10.05.2007 i lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, faqe nr.2 dhe faqe nr.43 të studimit-hulumtimit të publikuar nga kundërshtarja e sigurimit me datë 25.09.2018, me titull "Stafi Akademik i UP-së", studimet angazhimet tjera, plagjiaturat, vlerësimet dhe përpjesa staf-student, komunikimin me Postën Elektronike në mes të propozuesit dhe të portalit "Kallxo.com" si dhe publikimin e hulumtimit-studimit, të punuar nga kundërshtarja e sigurimit, në ueb-faqen e portalit "Kallxo.com", deklarata e propozuesit të sigurimit e dhënë në cilësinë e palës, në seancën e datës 29.10.2018, raporti mjekësor i datës 27.10.2018, deklarata e drejtuesit - themeluesit të OJQ "ADMOVERE" e dhënë në seancën e datës 29.10.2018 në cilësinë e palës në procedurë etj.

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se propozuesi i sigurimit e ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të të drejtës subjektive të tij. E njëjta gjykatë ka vlerësuar gjithashtu se ekziston rreziku për realizimin e të drejtës subjektive nga paditësi - propozuesi i sigurimit, pa lëshimin e masës së sigurisë në këtë rast, ngase do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit, sidomos në rast se kundërshtarja e sigurimit do ti përsërisë veprimet e tilla në të ardhmen lidhur me çështjen lëndore, bazuar në nenin 297 par. 1 pika b) të LPK-së, në të cilin përcaktohet se "në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së tillë pala kundërshtare do të mund ta pa mundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkim apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit", lidhur me nenin 4 par.1 të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, në të cilin përcaktohet se: "një person ka të drejtë të kërkojë përmes procedurës gjyqësore të ndal shpifjen dhe fyerjen dhe premtimin se shpifja apo fyerja nuk do të përsëritet në të ardhmen, tërheqjen e informacionit shpifës apo fyes ndaj personalitetit të tij/saj dhe kompensimin për dëmin moral dhe material të shkaktuar nga shpifja dhe fyerja, përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësisë në pajtim me këtë Ligj".

Vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë, kolegji i Gjykatës së Apelit të Kosovës nuk e miraton dhe vlerëson se aktvendimi i atakuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe është bërë edhe zbatimi i gabuar i të drejtës materiale. Shkeljet e dispozitave kontestimore konsistojnë në shkelje nga neni 182.2 pika n), pasi që në aktvendim nuk janë treguar arsyet mbi faktet vendimtare, arsyet janë të pa qarta dhe kontradiktore dhe se ekzistojnë kundërthënie midis asaj që është thënë në arsyetimin e aktvendimit dhe asaj që përmbahet në shkresat e lëndës. Kolegji gjenë se në rastin konkret nuk është vërtetuar në mënyrë dhe masë të plotë gjendja faktike (neni 183 i LPK-së), ndërsa shkeljet e të drejtës materiale konsistojnë në nenin 184 dhe 160.4, lidhur me nenin 297 të LPK-së, nenin 4 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes dhe neneve 6, 8 dhe 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut.

Lidhur me ekzistimin e shkeljeve esenciale kolegji vlerëson se, në arsyetimin e vendimit të dhënë nga ana e gjykatës së shkallës së parë konstatohet se propozuesi i sigurimit e ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të të drejtës subjektive të tij. Sipas vlerësimit të kolegjit, gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye mbi faktet vendimtare pasi që nuk ka treguar në

radhë të parë se cila është e drejta subjektive e propozuesit që është cenuar, se në ç' mënyrë propozuesi e ka bërë të besueshme ekzistimin e të drejtës së tij subjektive, në çka konsiston kjo besueshmëri e bërë etj. Në këtë pikë kolegji i gjykatës së shkallës së dytë vlerëson se nuk është e mjaftueshme që vetëm të konstatohet se besueshmëria ekziston, por duhet që të dihet edhe se cila është përmbajtja substanciale e kësaj besueshmërie dhe në çfarë konsiston ajo.

Kolegji vlerëson gjithashtu se, në vendimin e gjykatës së shkallës së parë është thënë se "ekziston rreziku se pa caktimin e masës pala kundërshtarë do të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës....ose do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit". Lidhur me këtë, kolegji gjenë se edhe në këtë pjesë nga ana e gjykatës së shkallës së parë nuk jepen arsyet pse është vendosur dhe në çka konsiston ky rrezik që do të pamundësonte realizimin e kërkesës së propozuesit të sigurimit dhe se cili do të ishte *ndikimi negativ* në të drejtat e propozuesit. Në nenin 160.4 të LPK-së është përcaktuar se arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato. Kolegji gjenë se arsyetimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë nuk përmban ndonjë arsye pse dhe si masa e sigurisë është e nevojshme për të evituar ndonjë rrezik ose dëm të riparueshëm dhe nuk është argumentuar baza reale e shkakimit të rrezikut apo dëmit të riparueshëm, vlera e të cilit është e pa kompensueshme qoftë në kuptimin material apo monetar. Kolegji gjenë, se arsyetimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë më shumë shprehë parafrazim të dispozitave ligjore pa dhënë kështu arsye konkrete për mënyrën se si është vendosur dhe përse është vendosur në mënyrën e tillë.

Shkeljet nga neni 183 i LPK-së konsistojnë në atë se në procedurën para gjykatës së shkallës së parë, nuk është marrë në vlerësim ekzistimi i dy vendimeve ai i Senatit të Universitetit nr.112 i datës 15.01.2007 dhe vendimi i Rektoratit të Universitetit të Prishtinës Ref.nr.1/191 i datës 10.05.2007 dhe nuk është vërtetuar nëse e paditura – kundërshtarja e sigurimit ka pasur njohuri për ekzistimin, si dhe nëse e paditura – kundërshtarja e sigurimit ka ndërmarrë masat e nevojshme lidhur me verifikimin e informatës.

Shkeljet në lidhje me nenin 184 të LPK-së dhe nenin 6 të KEDNJ-së, sipas vlerësimit të kolegjit konsistojnë në atë se e drejta për një gjykim të drejtë përfshin ndër të tjera edhe të drejtën për një vendim të mirë arsyetuar. Në rastin *Suominen kundër Finlandës* GJEDNJ është shprehur se, edhe pse gjykatat kanë liri të caktuar të vlerësimit në zgjedhjen e argumenteve në një rast të veçantë dhe në pranimin e provave në mbështetje të parashtrësive të palëve, një gjykatë vendore është e detyruar të justifikojë aktivitetet duke dhënë arsyet për vendimet e saj. Ndërkaq, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në rastin nr. KI 135/14, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016 është shprehur se Aktgjykimi i Gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendim marrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk përmban fakte të vërtetuara, dispozitat ligjore përkatëse dhe marrëdhënien logjike midis tyre.

Në vazhden e këtyre që u cekën si më lartë, kolegji sjellë në vëmendje që Konventa mbron si lirinë e shprehjes neni (10), ashtu edhe privatësinë neni (8). Qëndrimi i gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është se, te të dyja të drejtat ka peshë dhe status të barabartë. Praktika e GJEDNJ

thekson se e drejta për mbrojtjen e reputacionit është e drejtë e mbrojtur nga neni 8 i Konventës, si pjesë e së drejtës për të respektuar jetën private. Megjithatë që të gjejë aplikim neni 8, sulmi kundër reputacionit të personit duhet të arrijë në nivel të rëndë, në atë mënyrë që të shkaktoj paragjykim të gëzimit të jetës private nga individi. Sipas praktikës së Gjykatës kur shqyrtohet nevoja e ndërhyrjes në një shoqëri demokratike në interes të “mbrojtjes së reputacionit ose të drejtat e të tjerëve”, Gjykatës mund t’i kërkohet të verifikoj të drejtpeshoj të dy vlerat e garantuara nga Konventa, e që mund të bie në kundërshtim me njëra tjetrën në raste të caktuara, konkretisht, nga njëra anë Liria e Shprehjes e mbrojtur nga neni 10, nga ana tjetër e drejta e respektit për jetën private e sanksionuar me nenin 8.

Lidhur me “kufijtë e caktuar” në kontekstin e mbrojtjes së reputacionit dhe të të drejtave të tjerëve GJEDNJ, është shprehur se “detyrat dhe përgjegjësitë” që qeverisin të drejtën e lirisë së shprehjes “janë domethënëse kur bëhet fjalë për të sulmuar reputacionin e një individi të përmendur me emër dhe për të shkelur të drejtat e të tjerëve” (*Tonsbergs Blad AS dhe Haukom kundër Norvegjisë*). Sipas praktikës së GJEDNJ kjo nënkupton se “duhen arsye të posaçme përpara se media të çlirohet nga detyrimi i zakonshëm për të vërtetuar deklaratat faktike që janë fyese për individët privat”. Nëse ekzistojnë arsye të tilla apo jo varet veçanërisht nga natyra dhe niveli i fyerjes në fjalë si dhe shkalla për të cilën media mund t’i konsideroj burimet e saj të arsyeshme në raport me akuzat”.

Për arsyet e thëna si më lartë, kolegji gjenë se qëndrojnë si të bazuara pretendimet ankimore të të paditurës – kundërshtares së sigurimit dhe ka marrë vendim që aktvendimi i goditur me ankesë të priset dhe çështja të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Në procedurë të serishme gjykata e shkallës së parë, udhëzohet që të bëjë eliminimin e të metave si më lartë, të konstatojë drejtë gjendjen faktike, të aplikojë në mënyrë të drejtë të drejtën materiale të nxjerr një vendim të drejtë, të ligjshëm dhe të mirë arsyetuar në këtë çështje kontestimore.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e pajtim me dispozitat e nenit 209 par.1, pika d) dhe 195 par.1 pika c) të LPK -së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

#### GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.5022/18 me datë 28.02.2019

Kryetari i kolegjit - gjykatësi,  
Dr.sc. Rafet Haxhaj, d.v



SAKTËSINË E KOPJES E VËRTETON  
IDHËHEQËSI I SHKRIMORES SË GJYKATËS  
TAÇNOST KOPJE POTVRDUJE  
RUKOVODI OC SUDSKE PISARNICE